

NË EMER TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRIZREN DEGA SUHAREKË, Gjyqtari Qemail Suka, me pjesëmarrjen e Sek. juridike Vjollca Haziraj, ne lenden penale PP.II.Nr.105-2/2016 te dt. 18.05.2016, ndaj të akuzuarit D. G. nga fshati D. KK Suhareke, për shkak të veprës penale posedim i paautorizuar i narkotikeve, substancave piskotrope nga neni 275 parag.2 lidhur me parag. 1 te KP-se, në prezencë të prokurorit te PTH-ës nga Prizreni Milot Krasniqi dhe te akuzuarit, në seancën e shqyrtimit fillestar , te mbajtur me dt.01.03.2018 mori publikisht dhe shpalli me date 14.03.2018 këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari D. G. nga i ati M., e ëma F., e lindur H., i lindur me dt. 15.10.1991, ne fshatin D., Komuna Suhareke, ku dhe tani jeton, ka te mbaruar arsimin e mesëm, i pa martuar, mekanik, i gjendjes se mesme ekonomike, shqiptar, Shtetas i Republikës se Kosovës.

ESHTË FAJTOR

Sepse me datën 27.01.2016, rreth orës 07:00, ne fshatin D. Komuna e Suharekës, pa autorizim posedon narkotike, substanca psikotrope ose analoge, ne atë mënyrë qe gjate një kontrolli te ushtruar nga ana e policisë me urdhëresë te gjykatës ne shtëpinë e te pandehurit hasin një sasi me substanca narkotike, ku pas ekspertizës se bere nga ana e njësisë se shkencave Ligjore, Analiza Kimike, me numër. AFK\2016-0...\2016-2..., te datës 11.03.2016, vërtetohet se substanca narkotike është e llojit marihuan ne sasi prej 0.20 gram.

Me qka ka kryer veprën penale posedimi i paautorizuar i narkotikeve, substancave piskotrope nga neni 275 parag.2 lidhur me parag. 1 te KP-se

Andaj gjykata në kuptim të nenit 41,51,52, 73,74 KP si dhe 359 parag. 1 dhe 2,dhe neni 325 parag.2 KPK-ës të akuzuarit, i shqipton :

DENIM ME GJOBE

Ne shume prej 100 euro, i cili dënim duhet te paguhet pas plotfuqishmërisë se ketij aktgjykimi.

Nëse i akuzuari dënimin ne te holla nuk e paguan ne afatin e parapare, Gjykata dënimin me gjobe do te ia zëvendësoi me dënim me burgim ne kohëzgjatje prej 5-diteve, duke e llogaritur me nga 20 € për qdo dite burgimi.

I shqiptohet dënimi plotësues – i konfiskohet 1 (një) qese plastike mbështjell me foli me substance narkotike te llojit marihuan ne sasi prej 1.81 gr.

Obligohet i akuzuari qe ne emër te paushallit gjyqësor te paguaj shumen prej 20 euro, si dhe ne emër te kompensimit te viktimave shumen prej 30 euro, pas plotfuqishmërisë se ketij aktgjykimi.

A r s y e t i m

PTH ne Prizren PP.II.Nr. 105-2/2016 te dt. 18.05.2016, e ka akuzuar D. G. nga fshati D., për shkak të veprës penale posedim i paautorizuar i narkotikeve, substancave psikotrope nga neni 275 paragraf 2 lidhur me paragraf 1 te KP-se, në prezencë të prokurorit te PTH nga Prizreni Milot Krasniqi dhe te akuzuarit, në seancën e shqyrtimit fillestar, te mbajtur me dt.18.05.2016 i cili ngel ne tërësi pranë aktakuzës duke kërkuar qe i akuzuari te shpallet fajtor dhe te dënohet ne baze te ligjit.

Gjykata ne shqyrtimin e sotëm dhe me vet pranimin nga ana e te akuzuarit ka vërtetuar gjendjen faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Këtë gjendje faktike gjykata e ka vërtetuar nga vet pranimi i te akuzuarit i cili ne shqyrtimin fillestare e ka pranuar fajësinë.

Gjykata sipas detyrës zyrtare konform nenit 257 te KPP-ës ne shkresat e lendes nuk ka gjetur ndonjë prove te pa pranueshme dhe po ashtu gjykata ka vërtetuar se i akuzuari, e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi te fajësisë, pranimi i fajit nga ana e te akuzuarit, është bere vullnetarisht ne shqyrtimin fillestare pranimi është mbështetur ne faktet e çështjes qe përmban aktakuza, te cilat gjinden ne shkresat e lendes si dhe provat materiale te paraqitura ndaj te akuzuarit nga ana e PTH ne Prizren.

Gjykata po ashtu ne tërësi ka ardhur ne përfundim se pranimi i fajësisë ne shqyrtimin fillestare nga ana e te akuzuarit, është bërë ne pajtim me dispozitat e nenit 248 te KPP-ës, nga se nuk ekziston ndonjë nga arsyeset dhe kushtet për hudhjen e aktakuzës, apo pushimin e procedurës penale.

Nga këto fakte te cilat i përmban aktakuza, Gjykata ka ardhur ne përfundim se me veprimet e te akuzuarit formohen te gjitha elementet e veprës penale posedim i paautorizuar i narkotikeve, substancave psikotrope nga neni 275 paragraf 2 lidhur me paragraf 1 te KP-se, andaj Gjykata ka vendosur te akuzuarin ta shpall fajtor dhe t'ia shqiptoi dënim me gjobe ne shumen prej 100 euro i cili dënim do te ekzekutohet pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi.

Gjykata gjate marrjes se vendimit mbi dënimin ka vlerësuar te gjitha rrethanat ne kuptim te nenit 73 te KP-ës, te cilat ndikojnë ne lartësinë e dënimit.

Gjykata si rrethane lehtësuese mori për baze se i akuzuari ka pasur qëndrim korrekt ndaj Gjykatës, ka bere pranimin e fajësisë ne mënyrë vullnetare, është penduar për veprën e kryer, është hera e pare qe bie ndesh me Ligjin, kurse rrethane posaçërisht renduese nuk gjeti.

Vendimi mbi kërkesën pasurore juridike e mori ne kuptim te nenit 463 te KPP-ës . Vendimi mbi shpenzimet e procedurës u mori ne kuptim te nenit 452 paragraf 1 te KPP.

GJYKATA THEMELORE PRIZREN – DEGA SUHAREKË

Gjyqtari
Qemail Suka

KESHILLE JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 dite, nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtine, përmes kësaj Gjykate.